



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 20, datë 04.03.2019

PËR

**REFUZIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN/PAJISJEN ME LICENCË PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME PRANË SHOQËRISË
SË SIGURIMEVE “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A., Z. EGLENT BICI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 199, pika 3), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe nenit 15, pika 2 të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Shoqëria e sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a. ka depozituar në Autoritet, me shkresën nr. 121 prot., datë 10.01.2019 (protokolluar në AMF me nr. 147 prot., datë 11.01.2018), kërkesën dhe dokumentacionin për miratimin e z. Eglent Bici për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të saj.

Lidhur me z. Eglent Bici, Autoriteti ka trajtuar disa problematika që lidhen me veprimtarinë e këtij personi.

Fillimisht z. Bici është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare si agjent i shoqërisë “Insig” sh.a., me nr. licence 940, datë 20.10.2017.

Autoriteti është vënë në dijeni se është hapur një portal me emrin “eSig.al”, portal i cili administrohej nga shtetasi z. Eglent Bici. Ky portal (eSig.al) lidhej me ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit për të cilin z. Bici nuk ishte i licencuar nga Autoriteti.

Autoriteti pasi analizoi rastin në fjalë, konstatoi se veprimtaria e z. Bici nëpërmjet këtij portali, është veprimtari brokerimi, e cila është në kundërshtim me nenin 202 e vijues të Ligjit nr. 52 datë 22.04.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, në të cilin thuhet se veprimtaria e

brokerimit kryhet nga brokeri në sigurime, person juridik, i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Gjithashtu, personat e palicencuar, sipas dispozitave të këtij ligji, nuk mund të përdorin emrin sigurim ose risigurim, si dhe derivatë të tij. Përdorimi në këtë rast i emrit “eSig”, përbën shkelje dhe është objekt i sanksioneve të parashikuara në pikën 4 të nenit 251, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Autoriteti i është drejtuar z. Bici edhe me shkresën nr. 612 prot., datë 14.02.2018, duke kërkuar mbylljen menjëherë të portalit “eSig.al”, dhe duke njoftuar Autoritetin brenda datës 16.02.2018.

Z. Eglent Bici, ka depozituar shkresë më datë 16.02.2018, ku informonte se portali “eSig.al”, nuk ka pasur për objekt brokerimin dhe nuk ka për qëllim përfitimin nga shitja e produkteve, por ka vetëm qëllim informues dhe ndërgjegjësues për konsumatorin, aktorët e tregut, çmimet e tregut, produktet etj. Po kështu z. Bici nëpërmjet kësaj shkrese bën me dije se ka hequr dorë plotësisht nga pronësia e këtij portali (eSig.al) duke ja shitur këtë web një personi të tretë të interesuar.

Në këto kushte, AMF ka marrë Vendimin nr. 42 datë 26.02.2018 ku kërkohet çregjistrimi i portalit dhe njoftimi i AKEP-it për çregjistrim të tij (dërguar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare me shkresën nr. 829/1 datë 07.03.2018).

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare me shkresën nr. 829/2 datë 23.03.2018, i bën me dije Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, se bazuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 2, datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën AL” etj., ka kryer çregjistrimin e domain-it “eSig.al” nga sistemi.

Lidhur me këtë veprim, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe WebHost është thirrur në gjykatë, në cilësinë e personit të tretë nga AKEP, për çështjen administrative me palë ndërgjyqëse: Padiës: E. H, i paditur: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike.

Sqarojmë se z. E. H ishte përdoruesi i ligjshëm i portalit “eSig.al”, blerë në datë 26 tetor 2017.

Siç konstatohet më sipër veprimtaria e z. Bici nëpërmjet portalit “eSig.al”, është veprimtari brokerimi, e cila është kryer në kundërshtim me nenin 202 e vijues të Ligjit nr. 52 datë 22.04.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. (Kjo shkeje është konfirmuar dhe në mbylljen e çështjes gjyqësore e cila është fituar në Gjykatën e Shkallës së Parë nga AKEP duke rrëzuar kërkesë padinë me vendimin nr. 3211 dt. 18.09.2018, vendim i cili është ankimuar nga z. E.H me nr. prot 3327 datë 05.10.2018).

Ky veprim bazuar në nenin 15, pika 2 e Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015, konsiderohet shkelje e legjislacionit të zbatueshëm në fushën e sigurimeve, dhe konsiderohet rast për mospranimin e miratimit/refuzimit të licencës së agentit në sigurime.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 199, pika 3), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe nenit 15, pika 2 të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015, të refuzohet kërkesa e z. Eglent Bici, për miratimin/pajisjen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime pranë shoqërisë së sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.
2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI